



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.28.02.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Nazlije Shala (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Drejtorët komunak dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024
4. Shqyrtimi i Planit të Punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2025 dhe Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Enver Gashi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua unanimisht.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Vlora Mjekiqi Kabashi dhe Albana Shillova Shalaku.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika 3 e rendit të ditës

Enver Gashi – Paraqiti Raportin vjetor të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024.

Ajet Berisha – Në këtë raport janë 2 momente, ka plot tjera, por nuk dua të marrë kohë. Te Drejtoria për kulturë, rini dhe sport, kur është fjala te subvencionet në raport përpiqet me i shpjegue procedurat e kandidimit, procedurat e shpalljes gjë që për mua nuk është e nevojshme. Nuk është e nevojshme të

ngarkohet raporti se u bë në këtë ditë shpallja, u bë Komisioni, aplikuan edhe i ndamë. Më e rëndësishme se krejtë kjo për neve është me pa se kush është subvencionue, e jo procedura sepse për procedura mendoj se ka elemente tjera, që i përcjellin dhe në rast se nuk i keni zbatue atëherë merren masa. Për neve si anëtarë të Kuvendit Komunal është me rëndësi me pa se cilat prej grupeve sportive dhe individëve janë subvencionue, e këtu nuk pasqyrohet. E dyta, është se në mbledhjen e kaluar e kam bërë një vërejtje për një projekt i cili nuk është ekzekutue në rr.”Adem Jashari” thotë parkingu për vetura i realizuar qind për qind. Në mbledhjen e kaluar unë bëra vërejtje dhe është mirë me ditë Ekzekutivi në këtë rast se raportimi jo i saktë që konsideroj se jeni të vetëdijshëm se shmangia nga realiteti, apo edhe raportimi i rrejshëm është vepër penale. Këtë duhet me pasë parasysh ose nuk po i merrni absolutisht serioze vërejtjet që po i bëjmë. Unë në mbledhjen e kaluar se e patëm raportin financiar thashë se ky projekt nuk di se ku është kryer e thanë jo na i ka marrë Gjykata diçka, e nëse i ka marrë pse e keni paraqitë si projekt të kryer qind për qind.

Zarife Behluli – Sqaron se projekti ndërtimi i parkingut në rr.”Adem Jashari” dihet që e ka kodin e vet mirëpo, duke pasë parasysh që kontratat kolektive janë duke u ekzekutuar nga thesari i Kosovës dhe nuk i respektojnë rregullat se ku duhet me i marrë mjetet, pasi që kjo i takon kategorisë së pagave dhe meditimeve thesari është duke i marrë në të gjitha kategoritë ekonomike, sidomos nëpër investime kapitale nuk po ka mëshirë fare. Pasi që është project ne nuk mundemi me ia ndërrue destinimin, por këto i keni të cekura në raportin janar – shtator 2024, ku i kam cekë të gjitha se ku janë marrë mjetet dhe çka ka ndodhë me ato mjete. Edhe një herë po ju sqaroj se në paga dhe meditime janë ekzekutue mjete 162,624.95, në mallra dhe shërbime janë ekzekutue 120, 491.61, në shpenzime komunale 166,358.71, në subvencione dhe transfere 131,848.74, dhe në investime kapitale 748, 804.37 që në total janë 1,330,128.38. Këtu, ne kemi projekte që kemi lidhë kontrata në vitin 2024 dhe kanë mbetë kontratat e lidhura, por kanë mbetë pa buxhet. Tani, operatorët ekonomik janë duke shkue prapë me ankesa nëpër Gjykata me përmbaues privat, kështu që jemi në një gjendje shumë të rëndë financiare sa i përket ekzekutimit të mjeteve nga thesari. Unë prapë po iu japë një sqarim se te projekti i kogjenerimit sivjet janë ekzekutue mjete 870,000 euro, në emër të kontratave kolektive, kështu që projekti është minus për ato mjete për vitin 2025.

Ajet Berisha – Drejtoreshë, e kam paarsysh se këtë përgjegje e kemi pasë edhe në mbledhjen e kaluar dhe unë e kam informatën se ato mjete kanë shkue për shkak të vendimit të Gjykatës, kontrata kolektive. Problemin e kam sepse aty po thotë se është realizue projekti, do të thotë qysh me menaxhë këtë situatë që ne mos me kuptue gabim, apo raportimi me qenë korrekt. Gjykata i ka tërheqë qind për qind të atyre mjeteve, por projekti nuk është realizue, do të thotë vetëm këtë problem e kam.

Zarife Behluli – Këtë problem e kemi cekë edhe ne në Asociacionin e Komunave dhe në Departamentin e buxhetit të Ministrisë së financave. Ata po thojnë njëherë përnjëherë nuk dijmë çka me bë, raportoni fer dhe që është një përqindje e realizuar jofer.

Pika 4 e rendit të ditës

Enver Gashi – Paraqiti shqyrtimin e Planit të Punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2025 dhe Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit.

Sami Ahmeti – Sa i përket Planit të punës, nuk është që jam marrë shumë me të. Te dokumenti i Prokurimit ndoshta edhe nuk po kuptoj deshta, pak a shumë vetëm një sqarim te pika 10 thotë furnizimi dhe vendosja e klimave në objektet arsimore, sasia 3 a janë 3 shkolla apo çka janë sepse 3 x 83,333 dhe cilat janë ato shkolla. Te pika 18 përfaqësimi ligjor i Komunës së Obiliqit në Gjykata, përsëri sasia 3 nga 35,000 euro, 105,000 euro, a mund të dijmë se çka është duke përfaqësue Komuna. Përndryshe, për të tjerat nuk kam ndonjë vërejtje.

Enver Gashi – Meqë, nuk janë personat përgjegjës në mbledhje përgjegjet do ti merrni më vonë.

Pika 5 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi pasë një kërkesë nga Adnan Krasniqi dhe të gjithë kemi qenë për me i ndihmue, ia kemi rekomandue Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe sport shqyrtimin e kërkesës për mbështetje për ndërtimin e memorialit të dëshmorit Murat Krasniqi. Besoj se shumë shpejtë edhe Drejtoria do të vjen me një rekomandim, apo propozim dhe kryhet edhe ajo çështje.

Ajet Berisha – Unë kërkesën e pashë dhe e pashë se ju si Komitet ia keni drejtue Drejtorisë përkatëse dhe ai thotë me ndihmë që nënkupton se ai diçka don me bë dhe me i ndihmë edhe Komuna. Mendoj se ne nuk është dashtë me lejue këtë formë si Asamble edhe si Komunë sepse është përgjegjësi e jona për gjithë këta njerëz që kanë dhënë për vendin me marrë përsipër ne vetë si Komunë. Pra, për aq sa mundemi me një plan më afatgjatë për 5,6 vite që kanë me u përfundue bustat, statujat apo diçka që planifikojmë kishte me qenë mirë këtu, e jo kërkesat ad-hoc që na vijnë prej familjarëve, që fatkeqësisht deri më sot nuk i kemi krye dhe e di që është e rëndë me i thënë edhe atij prit pak se e kemi në plan ne me i krye të gjitha. Mendoj se më korrekte kishte me qenë edhe për ata që kanë dhënë shumë për këtë vend, por edhe për familjet e tyre që vërtetë kanë dëshirë me u pa diçka minimalisht nga ajo që ata kanë kontribue shumë. Kishte me qenë mirë që Drejtoria për kulturë, rini dhe sport me analizue në mënyrë më të thukët qysh me u bë një plan më afatgjatë i cili kishte me paraparë hapat për secilin prej tyre qysh kanë me realizue projektin.

Enver Gashi – Të gjitha kërkesat që i adresohen Kuvendit, ne duhet ti shqyrtojmë dhe është rregullë që së pari të shkojnë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Ne e kemi bë një Rregullore të brendshme që asnjë kërkesë ne të mos e shqyrtojmë pa e marrë Drejtoria përkatëse. Mendoj se kemi bërë mirë se kërkesën e kemi drejtue në adresën e duhur ndërsa, plani i punës mund të bëhet.

Sami Ahmeti – Është plotësisht ashtu se zakonisht edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, ne kur i trajtojmë kërkesat që vijnë qytetarët nuk janë të informuar për secilën pikë se ku saktësisht mund të bëjnë kërkesa, e dijnë që Kuvendi është organi më i lartë dhe jam dakord që të shkojnë në Drejtorinë përkatëse. Ajo që nuk jam dakord është që po ndodhë që kërkesat e caktuara po shkojnë dhe më ne nuk po kemi asnjë informacion. Në seancën e kaluar kemi pasë një kërkesë, kemi pasë një petition të qytetarëve për çështjen e transportit publik dhe i kemi rekomandue Drejtorive përkatëse me u marrë me këtë çështje. Do të ishte mirë kurdo që të përmbillet një lëndë e tillë ta kemi edhe ne një përgjegje sepse deshtëm, apo nuk deshtëm kërkesa ka shkue edhe përmes neve, sepse edhe ne përfaqësojmë diçka. Përndryshe, në rregullë jemi sepse kërkesat kur po vijnë prej qytetarëve, ato po vijnë vetëm me versionin e tyre çka do të dëshironin dhe si dojnë dhe paralelisht kësaj ne nuk mund të miratojmë diçka pa e marrë edhe anën tjetër të Drejtorive përkatëse.

Pika 6 e rendit të ditës

Enver Gashi – Pasi që nuk kemi asnjë diskutim në këtë pikë të rendit të ditës, e përfundojmë mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:21'

Bashk. prof. për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesi i mbledhjes

Enver Gashi



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

IZVOD IZ ZAPISNIKA

Sa sednice Skupštine opštine održane 28.02.2025.godine u 11:00 časova, u sali Skupštine opštine.

Prisutni članovi SO: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Nazlije Shala (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristić (SL) i Biljana Spasić(SL).

Ostali prisutni: opštinski direktori i predstavnici KFOR-a.

Sastanak je vodio Enver Gaši, najstariji odbornik Skupštine opštine, koji nakon što je konstatovao da postoji kvorum, započeo sastanak sa sledećim:

DNEVNIM REDOM

1. Obrazloženje za odsustvo
2. Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prethodnog sastanka
3. Godišnji izveštaj o radu predsednika opštine i izvršne vlasti za 2024. godinu
4. Razmatranje plana rada Gradonačelnika opštine i izvršne vlasti za 2025. godinu i Finalno planiranje nabavke
5. Razmatranje zahteva
6. Razno

Enver Gashi – upoznao je prisutne sa dnevnim redom koji je jednoglasno usvojen.

Tačka 1. dnevnog reda

Odsutni: Vlora Mjekiqi Kabashi i Albana Shillova Shalaku

Tačka 2. dnevnog reda

Izvod iz zapisnika sa prethodnog sastanka je jednoglasno usvojen.

Tačka 3. dnevnog reda

Enver Gashi – Predstavio godišnji izveštaj o radu gradonačelnika i izvršne vlasti za 2024. godinu.

Ajet Berisha – U ovom izveštaju imamo 2 momenta, ima ih mnogo više, ali ne želim da oduzimam vreme. U Upravi za kulturu, omladinu i sport, kada je reč o subvencijama, izveštaj pokušava da objasni proceduru prijave, raspisne procedure, što za mene nije potrebno. Nije potrebno opteretiti izveštaj da je nesto saopšteno. Nama je važnije od svega toga ko je subvencionisan, a ne procedura, jer mislim da postoje drugi elementi koji prate proceduru i ako to niste sprovedi onda se preduzimaju mere. Za nas kao odbornike u Skupštini opštine važno je da se od sportskih grupa i pojedinaca subvencionise, a to se ovde ne odražava. Drugi je da sam na poslednjem sastanku dao primedbu o projektu koji nije realizovan u ulici „Adem

Jashari“, parking za vozila je 100% završen. Na prošlom sastanku sam dao primedbu za netačno izveštavanje za koje smatram da ste svesni da je izbegavanje stvarnosti, pa čak i lažno prijavljivanje krivično delo. Ovo morate uzeti u obzir ili ne shvatate apsolutno ozbiljno primedbe koje dajemo. Na poslednjem sastanku kada smo imali finansijski izveštaj, ja sam rekao da ne znam gde je ovaj projekat završen, a izjavili ste, sud nam je nešto oduzeo, a ako jeste, zašto ste to prikazali kao 100% završen projekat.

Zarife Behluli –pojašnjava da je poznato da projekat izgradnje parkinga u ulici „Adema Jašarija“ ima svoju šifru, ali s obzirom na to da se kolektivni ugovori sprovode u kosovskom trezoru i ne poštuju pravila gde se oduzimaju sredstva, jer ovo spada u kategoriju plata i naknada, trezor ih ne može menjati u svim ekonomskim kategorijama, a pogotovo ne u kapitalnim projektima. Još jednom vam objašnjavam da je na plate i zarade potrošeno 162.624,95 sredstava, na robe i usluge 120.491,61, na opštinske troškove 166.358,71, na subvencije i transfere 131.848,74, a na kapitalne investicije 738.804. Imamo projekte za koje smo potpisali ugovore 2024. godine, ali su ostali bez budžeta. Sada privredni subjekti ponovo idu sa pritužbama preko sudova kod privatnih izvršitelja, tako da smo u veoma teškoj finansijskoj situaciji u vezi sa izvršenjem sredstava iz trezora. U projektu Parnog grejanja ove godine realizovana sredstva od 870.000 evra, na ime kolektivnih ugovora, tako da je projekat u minusu za 2025. godinu.

Ajet Berisha – Direktorice, na prošlom sastanku dobili ovaj odgovor i imam informaciju da su ta sredstva otišla zbog susdskih odluka, kolektivnih ugovora. Imam problem jer se kaže da je projekat završen, znači da ste se snašli u ovoj situaciji da ne bismo pogrešno razumeli, odnosno da je izveštavanje bilo tačno. Sud je povukao 100% tih sredstava, ali projekat nije realizovan.

Zarife Behluli – Ovaj problem smo pominjali i u Zajednici opština i u Odeljenju za budžet Ministarstva finansija. Kažu za sada, ne znamo šta da radimo, izvestavajte tacno.

Tačka 4. dnevnog reda

Enver Gashi – On je predstavio pregled Plana rada Gradonačelnika i opštinske izvršne vlasti za 2025. godinu i Završnog plana nabavke.

Sami Ahmeti – Što se tiče plana rada, nije da sam bio previše bavio njime. U dokumentu Nabavke, možda ni ja ne razumem, pa tražim pojašnjenje u tački 10, stoji Nabavka i ugradnja klima u obrazovne objekte, količina 3 su 3 škole ili šta su jer 3k 83.333 i koje su to škole. U tački 18, pravno zastupanje opštine Obilić, opet iznos 3 od 35.000 evra, 105.000 evra, možemo li znati šta opština zastupa. Inače, za ostale nemam komentare.

Enver Gashi – Pošto na sastanku nema odgovornih lica, odgovore ćete dobiti naknadno.

Pika 5 e rendit të ditës

Enver Gashi – Na sednici Komiteta za politiku i finansije dobili smo zahtev od Adnana Krasniqija i svi smo da pomognemo, preporučili smo Upravi za kulturu, omladinu i sport razmatranje zahteva za podršku za izgradnju spomen obeležja palog borca Murata Krasniqija. Verujem da će vrlo brzo Direkcija doći sa preporukom ili predlogom i ta stvar će biti završena.

Ajet Berisha – Video sam zahtev, vi kao Komitet uputili ste resornoj direkciji. Znači da on želi nešto da uradi i opština takođe da je pomaze. Mislim da ne treba da dozvolimo ovaj oblik kao Skupština i kao opština jer je naša odgovornost da svi ovi ljudi koji su dali za zemlju preuzmemo na sebe kao opština. Dakle, koliko možemo sa dugoročnim planom za 5,6 godina, a ne ad-hoc zahtevi koji nam stižu od članova porodice, a koje nažalost nismo ispunili do danas i znam da je teško reći da malo sačeka. Mislim da bi bilo ispravnije za one koji su mnogo dali ovoj zemlji, ali i za njihove porodice koje zaista žele da vide bar nešto od onoga čemu su mnogo doprinele. Bilo bi bolje da je Uprava za kulturu, omladinu i sport to detaljnije analizirala, pošto je napravljen dugoročni.

Enver Gashi – Moramo da razmotrimo sve zahteve upućene Skupštini i pravilo je da prvo razmotri Komitet za politiku i finansije. Napravili smo interni propis da ne razmatramo nijedan zahtev, a da ga ne dobijemo od resorne direkcije, mislim da smo dobro uradili što smo zahtev uputili na pravu adresu dok se može napraviti plan rada.

Sami Ahmeti – tako je, o zahtevima Odbora za politiku i finansije , koji dolaze od građana koji nisu obavešteni o svakoj tački gde t tačno mogu da upućuju zahteva, znaju da je Skupština najviši organ i slažem se da treba da odu u resornu direkciju. Ono sa čime se ne slažem je da se dešava da određeni zahtevi idu, a mi nemamo dalje informacije. Na prošloj sednici smo imali zahtev, peticiju građana po tom pitanju javnog prevoza i preporučili smo nadležnim direkcijama da se pozabave ovim pitanjem.

Tačka 6. dnevnog reda


Enver Gashi – Pošto nemamo druge zahteve o ovoj tački dnevnog reda, završavamo današnju sednicu.

Sastanak je završen u 11:21'časova.

Stručno lice za posao SO


Azize Zeneli

Presedavajući sednice


Enver Gashi

